



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**PËR SIGURIMIN E JETËS TË LIDHUR ME PJESËMARRJEN NË
SIPËRMARRJET E INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE**

Miratuar me vendim Bordi nr. 60, datë 29.04.2025

**Neni 1
Objekti**

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i procedurave dhe rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së sigurimit të jetës të lidhur me pjesëmarrjen në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike, në vijim fondi i investimit.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", si dhe të ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

**Neni 3
Përkufizime**

1. Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) Shoqëri sigurimi – është shoqëria e sigurimit të jetës e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për ushtrimin e veprimtarisë në klasën 21, “Sigurimi i jetës në lidhje me sipërmarrjet e investimeve kolektive”, sipas seksionit B, aneksi I, të ligjit 52/2014.
 - b) Dokumenti i informacionit kryesor - është dokumenti me informacionin kryesor, i përgatitur nga shoqëria e sigurimit, për kontraktuesin/të siguruan, që i vihet në dispozicion këtij të fundit pa pagesë, përpara lidhjes së kontratës së sigurimit të jetës për blerjen e kuotave në fondet e investimit.
 - c) Portofoli investues – është numri i përgjithshëm i kuotave në fondin e investimit për një kontratë sigurimi.
 - ç) Vlera e portofolit investues - është vlera totale e aktiveve që i referohet numrit total të kuotave dhe çmimit të kuotës në ditën e llogaritjes.
2. Termat e tjera të përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe ligjin nr. 56/2020, datë 30.04.2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe akteve rregullatore të Autoritetit.

Neni 4 Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet nga shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtarinë e sigurimit në klasat e jetës për produktin e sigurimit të jetës të lidhur me pjesëmarrjen në fondet e investimit, ku i siguruari merr përsipër rrezikun e investimit.

Neni 5 Struktura e primit të sigurimit

Primi i sigurimit të jetës i lidhur me pjesëmarrjen në fondet e investimit, i cili paguhet nga i siguruari ose kontraktuesi, përbëhet nga:

- a) Primi për sigurimin e jetës – pjesa e primit të sigurimit që përdoret për mbulimin e ngjarjes së sigurimit në rastin e vdekjes dhe/ose të mbijetesës së të siguarit, për të cilin shoqëria e sigurimit mban provigjon matematik.
- b) Primi për investim – pjesë e primit të sigurimit që përdoret për blerjen e kuotave në fondet e investimit të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të cilën shoqëria e sigurimit të jetës mban provigjon të veçantë.
- c) Shpenzime operative – pjesë e primit të sigurimit i cili përfshin komisionin e ndërmjetësimit si dhe shpenzime të tjera administrative.

Neni 6

Investimi dhe raportimi

1. Shoqëria e sigurimit është e detyruar që primet për investim, për të cilat mban provigjon të veçantë, t'i investojë për blerjen e kuotave në fondet e investimit, të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
2. Shoqëria e sigurimit duhet të mbajë një regjistër të veçantë, në të cilin evidenton pjesëmarrjet në kuota në fondet e investimeve, të blera nga primi për investim për çdo kontraktues/të siguruar.
3. Regjistri i pjesëmarrjeve, sipas pikës 2 të këtij neni, për çdo kontraktues/të siguruar, duhet të përmbajë të paktën të dhënat si më poshtë:
 - a) Numrin e policave të sigurimit të jetës me pjesëmarrje në fondet e investimit;
 - b) Informacion për çdo të siguruar,
 - i. emër, mbiemër, gjini dhe atësi;
 - ii. data e lindjes, qyteti/shteti i lindjes dhe shtetësia;
 - iii. numri personal i identifikimit për shtetas shqiptarë dhe shtetas të huaj;
 - v. adresa e banimit, kodi postar, posta elektronike dhe numri i telefonit.
 - c) Informacion për çdo kontraktues:
 - i. Për person juridik: firma, selia dhe numri unik i identifikimit të subjektit, dhe
 - ii. Për person fizik: emër dhe mbiemër, datëlindja, adresa e saktë e vendbanimit.
 - d) Numrin dhe çmimin e kuotës në ditën e blerjes, vlera e përgjithshme e portofolit investues në ditën e blerjes së kuotës, si dhe fondet investuese;
 - e) Të dhënat e sakta të fondit të investimit ku janë investuar primet e investimit;
 - f) Informacion i saktë për çdo ndryshim të kuotave të pjesëmarrjes, të plotësuara me datë dhe orën e ndryshimit;
 - g) Gjendjen e kuotave, sipas përditësimit më të fundit, çmimi i kuotës dhe vlera e përgjithshme e portofolit investues.
4. Çdo ndryshim në regjistër dokumentohet si më poshtë:
 - a) Vërtetim për blerje apo shitje të kuotave në fond, të lëshuar nga shoqëria administruese e fondit pas arkëtimit apo pagesës së kryer;
 - b) Dokument i shoqërisë së sigurimit që vërteton se primi i sigurimit dhe shpenzimet e marrjes në sigurim janë mbajtur nga portofoli i investimit, në rastet kur është rënë dakord, sipas parashikimeve në kushtet e kontratës së sigurimit;
 - c) Dokument që vërteton statusin e portofolit investues dhe tjetërsimet për çdo ndryshim.
5. Shoqëria e sigurimit të jetës është e detyruar të ketë procedura të brendshme dhe sisteme të sigurisë për përditësimin dhe sigurinë e të dhënave të regjistrit të pjesëmarrjeve.

Neni 7

Elementet e detyrueshme të kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës

1. Shoqëria e sigurimit duhet të parashikojë, në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit, dispozitat si më poshtë:

- a) Në rast të bashkimit ose likuidimit të fondit të investimit, shoqëria e sigurimit duhet t'i japë mundësinë të siguruarit:
 - i. të kalojë në fond tjetër, të administruar nga e njëjta shoqëri administruese, ose
 - ii. të kalojë në fond tjetër të administruar nga shoqëri administruese tjetër.

I siguruari brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, duhet të shprehet lidhur me transferimin e parashikuar në shkronjën a) të këtij neni. Shpenzimet lidhur me transferimin merren përsipër nga shoqëria e sigurimit.

- b) Në rast kur i siguruari nuk pranon të kalojë në një fond tjetër investimi, sipas parashikimit të shkronjës "a" të këtij neni, shoqëria e sigurimit do t'i paguajë të siguruarit vlerën e portofolit investues pa aplikuar komision dalës dhe do t'i kthejë pjesën e pashfrytëzuar të primit për sigurim.
- c) Kufizime që koha ndërmjet arkëtimit të primit për investim dhe blerjes së kuotave të fondit të investimit, të jetë jo më shumë se 5 (pesë) ditë pune.

Neni 8

Arkëtimi i primit

1. Shoqëria e sigurimit, duhet të përcaktojë në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit të jetës me pjesëmarrje në fondet e investimit, primin e sigurimit, primin e investimit dhe shpenzimet operative, si dhe mënyrën se si do të kryhet arkëtimi i tyre.
2. Në rastet kur, në kushtet e përgjithshme ose të veçanta të kontratës është parashikuar se primi i sigurimit të arkëtohet nga portofoli investues, shoqëria e sigurimit të jetës në ditën në të cilën është parashikuar arkëtimi i primit të sigurimit, kryen blerje të kuotave të portofolit investues të kontraktuesit/të siguruarit dhe numri i kuotave të blera me çmimin e ditës që kryhet blerja duhet të jetë e barabartë me primin e sigurimit.
3. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të njoftojë kontraktuesin/ të siguruarin lidhur me numrin e kuotave të blera, çmimin e blerjes së kuotës të fondit të investimit dhe shpenzimet për këtë transaksion, për çdo blerje nga portofoli i investimit në përputhje me pikën 2, të këtij neni.

Neni 9

Informacion për çmimin e kuotave të fondeve të investimit

Shoqëria e sigurimit është e detyruar që të sigurojë të dhëna ditore për çmimin e kuotave të fondeve të investimit, të cilat janë pjesë përbërëse e produktit të sigurimit dhe t'i publikojë në faqen zyrtare të internetit ose të sigurojë ndërlidhjen nëpërmjet një link-u në burimin zyrtar të të dhënave që ka detyrim të njoftojnë.

Neni 10

Dokumenti me informacionin kryesor

1. Shoqëria e sigurimit ose ndërmjetësi në sigurime para lidhjes së kontratës së sigurimit duhet t'i vërë kontraktuesit/të siguruarit në dispozicion dokumentin me informacionin kryesor pa pagesë, në formë të shkruar dhe sipas kërkesës, t'ia mundësojë edhe në formatin elektronik nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi, duke u siguruar për dërgimin e dokumentit.
2. Dokumenti me informacionin kryesor duhet të vendoset për t'u shkarkuar edhe në faqen e internetit të shoqërisë së sigurimit. Përdorimi i logos së shoqërisë së sigurimit apo grupit të cilit ajo i përket, duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të mos tërheqë vëmendjen e kontraktuesit/të siguruarit apo të nënvlerësojë tekstin e dokumentit.
3. Dokumenti me informacionin kryesor përpilohet si dokument i shkurtër jo më pak se tre faqe, në format A4. Nëse në dokumentin me informacionin kryesor shfrytëzohen ngjyrat këto të fundit nuk duhet të reduktojnë kuptueshmërinë e informacionit të dhënë në dokument.
4. Dokumenti me informacionin kryesor për kontraktuesin/të siguruarin duhet të hartohet në mënyrë të tillë që:
 - a) Të jetë i paraqitur dhe i strukturuar thjeshtë për t'u lexuar, duke përdorur shkronja të një madhësie të përshtatshme;
 - b) Të jetë i fokusuar në informacione kryesore që i nevojiten kontraktuesit/të siguruarit;
 - c) Të jetë i shkruar qartë dhe me gjuhë që krijon lehtësi tek i siguruari të kuptojë informacionin i cili po i komunikohet.
 - ç) Të shmangë përdorimin e fjalëve të huaja dhe të pakuptueshme për publikun, si dhe dialektizmat; të përmbajë, aty ku mundet, fjalë të përditshme dhe të shmangë termat teknikë.
5. Dokumenti me informacionin kryesor duhet të përmbajë informacion para kontraktues, i cili duhet të jetë i saktë, i vërtetë, i qartë dhe i harmonizuar me të gjitha dokumentet e tjera pjesë përbërëse të produktit, si kushtet e kontratës së sigurimit, informacioni kryesor për investitorin dhe prospekti i fondit të investimit të përzgjedhur.

6. Dokumenti me informacionin kryesor është dokument i pavarur, i veçuar nga materialet promovuese të shoqërisë së sigurimit.

Neni 11

Struktura dhe përmbajtja e dokumentit me informacionin kryesor

1. Dokumenti me informacionin kryesor i përgatitur nga shoqëria e sigurimit duhet të përmbajë titullin *“Dokumenti me informacionin kryesor”* i cili paraqitet në një vend të dukshëm në faqen e parë të dokumentit. Nën titullin e dokumentit të vendoset shpjegimi, në të cilin të theksohet: *“Ky dokument përmban informacione kryesore për produktin e sigurimit të jetës i lidhur me sipërmarrjet e investimeve kolektive, ku i siguruari mbart rrezikun e investimit dhe ka për qëllim t’ju ndihmojë në të kuptuarit e natyrës, rreziqeve, shpenzimeve, fitimeve dhe humbjeve potenciale nga ky produkt, si dhe t’ju ndihmojë ta krahasoni me produktet e tjera. Ky dokument nuk paraqet material promovues (reklamues)”*.
2. Dokumenti me informacionin kryesor, sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje, përmban elementet në vijim:
 - a) Të dhëna të përgjithshme për produktin;
 - b) Cilat janë karakteristikat kryesore të produktit?;
 - c) Cilat janë rreziqet dhe pritshmëritë nga produkti?;
 - ç) Cilat janë pasojat në rastet kur shoqëria e administrimit nuk është në gjendje të paguajë?;
 - d) Cilat janë pasojat në rastet kur shoqëria e sigurimit nuk është në gjendje të paguajë?;
 - dh) Cilat dhe sa janë shpenzimet dhe tarifat që paguan kontraktuesi/i siguruari lidhur me produktin?;
 - e) Opsionet për ndërprerje të parakohshme të kontratës dhe pasojat;
 - ë) Si dhe ku mund të ankohet kontraktuesi/i siguruari? dhe
 - f) Informacione të tjera të nevojshme.
3. Forma dhe përmbajtja e “Dokumentit me informacionin kryesor”, detajohet në Aneksin 1, të kësaj rregulloreje.

Neni 12

Përditësimi i dokumentit me informacionin kryesor

1. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të përditësojë informacionet e përfshira në dokumentin me informacionin kryesor në të gjitha rastet kur ka ndryshime të cila ndikojnë dukshëm ose pritet se do të ndikojnë në informacionet e përfshira në dokument.
2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, të këtij neni, shoqëria e sigurimit është e detyruar të përditësojë dokumentin me informacionin kryesor në çdo tre muaj, brenda një afati prej 10 ditësh pas përfundimit të tremujorit.
3. Shoqëria duhet të publikojë dokumentin me informacionin kryesor të përditësuar, në faqen e saj të internetit me shënimin e datës në të cilën është bërë përditësimi.

Neni 13

Parimet themelore të përpilimit të dokumentit me informacionin kryesor dhe informacioni për veprimtarinë promovuese

1. Shoqëria e sigurimit është përgjegjëse për plotësimin dhe saktësimin e informacioneve që do të përfshihen në dokumentin me informacione kryesore, si dhe për informacionet që publikohen ose shpërndahen gjatë promovimit të produktit të sigurimit të jetës të lidhur me pjesëmarrjen në fondet e investimit.
2. Gjatë përpilimit të dokumentit me informacionin kryesor dhe materialit promovues për produktin e sigurimit, duhet të mbahen parasysh kriteret e mëposhtme:
 - a) qëllimi i promovimit nuk duhet të mbahet i fshehtë apo të prezantohet në mënyrë mashtruese;
 - b) produkti i sigurimit dhe rreziqet që lidhen me të, duhet të paraqiten dhe përshkruhen në mënyrë të plotë, të saktë dhe të vërtetë;
 - c) faktet dhe kuotimet e dhëna duhet të jenë të sakta, të qarta, të vërteta dhe të kuptueshme, në datën në të cilën jepen, si dhe nuk duhet të jenë çorientuese dhe çdo fakt i dhënë të jetë i vërtetueshëm;
 - d) të garantohet që paraqitja, përmbajtja ose forma e informacionit gjatë promovimit nuk shtrembëron, fsheh apo ul rëndësinë e deklaratave, paralajmërimeve ose referencave të përfshira në dokumentin me informacionin kryesor, si dhe në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta kontratës së sigurimit.

Neni 14

Njoftime të tjera para lidhjes së kontratës së sigurimit

Përveç dokumentit me informacionin kryesor, shoqëria para lidhjes së kontratës së sigurimit të jetës lidhur me pjesëmarrjen në fondet e investimit, duhet të njoftojë të kontraktuarin/siguruarin për shpërndarjen e primit sipas komponentëve përkatës (primi i investimit, primi i sigurimit, shpenzimet operative, taksat dhe shpenzimet e tjera që mund të lindin).

Neni 15

Informimi i kontraktuesit/të sigurvearit

1. Shoqëria e sigurimit të jetës është e detyruar që brenda një afati prej 30 ditësh, përpara mbarimit të vitit financiar, t'i dorëzojë kontraktuesit/të sigurvearit një raport vjetor për kontratën e sigurimit të jetës me pjesëmarrje në fondet e investimit.
2. Raporti vjetor sipas pikës 1, të këtij neni përfshin të paktën, të dhënat si më poshtë:
 - a) të gjitha kuotat e blera, primin e sigurimit, primin e investimit dhe shpenzimet operative;
 - b) shumën e portofolit investues në fillim të periudhës së sigurimit ose rinovimit të policës së sigurimit (përfshirë numrin e kuotave dhe çmimin e kuotës), përkatësisht nga fillimi i kontratës së sigurimit nëse është e lidhur gjatë vitit;

- c) ndryshimet që kanë ndodhur përgjatë vitit, të ndara për çdo ndryshim në portofolin investues përfshirë numrin dhe çmimin e kuotave, datën e ndryshimit si dhe përshkrimin e çdo transaksioni;
- ç) shuma e portofolit investues në fund të vitit (përfshirë numrin dhe çmimin e kuotave).

Neni 16

Regjistrimet kontabël dhe përgatitja e pasqyrave financiare

Shoqëria e sigurimit të jetës që ofron produktet e sigurimit të jetës me pjesëmarrje në fondet e investimit, duhet të hartojë pasqyra financiare në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë kontabilitetin dhe zbatimin e standardeve të raportimit financiar.

Neni 17

Detyrimi për informimin e Autoritetit

1. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet dokumentin me informacionin kryesor për çdo produkt të sigurimit të jetës, lidhur me pjesëmarrjen në fondet e investimit brenda 7 (shtatë) ditëve para fillimit të zbatimit të tij.
2. Dokumenti me informacionin kryesor, sipas pikës 1 të këtij neni, depozitohet edhe në formë elektronike.
3. Nëse Autoriteti vlerëson se dokumenti me informacionin kryesor përmban të dhëna ose informacion të pasaktë, keq orientues ose është në kundërshtim me këtë rregullore, i kërkon shoqërisë së sigurimit të korrigjojë dokumentin dhe ta ri depozitojë në Autoritet.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT ME INFORMACIONIN KRYESOR
HYRJE: Titulli i dokumentit me informacionin kryesor për kontraktuesin/ të siguruari vendoset në krye të faqes së parë, duke përdorur shprehjen: “Informacion kryesor për investitorin”. Poshtë titullit jepet një deklaratë, ku thuhet: <i>Ky dokument përmban informacionin kryesor për produktin e sigurimit të jetës të lidhur me pjesëmarrjen në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike, ku kontraktuesi/i siguruari merr përsipër rrezikun e investimit. Ky dokument ka për qëllim të ndihmojë në kuptimin e natyrës, rreziqeve, shpenzimeve, fitimeve dhe humbjeve potenciale nga ky produkt si dhe të ndihmojë ta krahasoni atë me produktet e tjera. Ky dokument nuk është material me karakter reklamues/promovues.</i>
I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME Në këtë pjesë të dokumentit duhet të jepen të dhënat identifikuese të shoqërisë së sigurimit të jetës e cila ofron produktin e sigurimit (ku kontraktuesi/ i siguruari e merr përsipër rrezikun e investimit). Ky dokument duhet të përmbajë elementët dhe informacionet në vijim: 1. Të dhënat lidhur me produktin e sigurimit, emërtimin, të dhëna të përgjithshme lidhur fondin e investimit, numrin identifikues i fondit; 2. Shoqërinë e sigurimit e cila ofron produktin, faqen e internetit në të cilin kontraktuesi/ i siguruari do të mund të marrë informacion, si të kontaktojë shoqërinë e sigurimit dhe numrin e telefonit; 3. Të dhënat për autoritetin kompetent mbikëqyrjes, përkatësisht të dhënat për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (adresa, faqja zyrtare e internetit dhe numri i telefonit); 4. Data e përgatitjes së dokumentit me informacionin kryesor, dhe në rast të përditësimit, data e përditësimit të fundit të dokumentit.
II. CILAT JANË KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË PRODUKTIT TË SIGURIMIT? Në këtë pjesë të dokumentit duhet të jepen të dhënat si më poshtë: - Përshkrimi i produktit të sigurimit Informacioni lidhur me qëllimin e produktit të sigurimit dhe mënyrën se si do të realizohet qëllimi, të përmbledhur në një pjesë të shkurtër, të qartë dhe të kuptueshme. - Qëllimi dhe mënyra e realizimit të qëllimeve Informacioni duhet të identifikojnë faktorët kryesorë nga të cilët varen të ardhurat, instrumentet financiare në të cilat investohen fondet, si përcaktohen të ardhurat dhe cila është lidhja ndërmjet të ardhurave të produktit të sigurimit dhe instrumenteve financiare

në të cilat investohen fondet. Informacioni duhet të pasqyrojë lidhjen ndërmjet periudhës së rekomanduar për investim dhe nivelit të rrezikut të produktit të sigurimit.

- **Grupi i synuar**

Në përshkrimin e grupit të synuar për të cilët është dedikuar ky produkt sigurimi, është e nevojshme të sigurohen informacionet për klientin e synuar dhe të identifikuar nga shoqëria, veçanërisht në lidhje me nevojat, karakteristikat dhe qëllimet e llojit të klientit për të cilët ky produkt është i përshtatshëm. Këto përshkrime kanë për qëllim të ndihmojnë të siguarin të kuptojë natyrën e produktit, rreziqet, shpenzimet, fitimet dhe humbjet potenciale nga ky produkt, si dhe nëse i siguruari është i aftë bazuar në njohuritë e tij lidhur me investimin dhe përvojës në tregjet financiare, të kuptojë rrezikun që mbart produkti dhe të përballojë humbjet nga investimi.

- **Përfitimet dhe shpenzimet nga produkti i sigurimit**

Në përshkrimin e detajuar të përfitimeve nga produkti, duhet të sigurohet një informacion/përmbledhje e përgjithshme, ku të pasqyrohen karakteristikat kryesore të kontratës së sigurimit, informacioni për të gjitha përfitimet me sqarimin se vlera e këtyre përfitimeve është paraqitur në pjesën “Cilat janë rreziqet dhe çfarë mund të fitoj si kthim?”.

Informacioni për afatin e fundit të mbulimit të produktit të sigurimit në pjesën nën titullin “Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produktit”.

Në dokument duhet të përfshihen gjithashtu të gjitha informacionet në vijim:

- Data e afatit të fundit të mbulimit të produktit të sigurimit ose shënimi se nuk ekziston datë e afatit të fundit të mbulimit;
- Informacion nëse shoqëria ka të drejtë ta ndërpresë në mënyrë të njëanshme kontratën e produktit të sigurimit;
- Përshkrim të rrethanave në të cilat produkti i sigurimit mund të ndërpritet automatikisht.

III. CILAT JANË RREZIQET DHE PRITSHMËRITË NGA PRODUKTI?

- **Treguesit e rrezikut**

Shoqëria duhet të publikojë treguesin sintetik mbi rrezikun dhe përfitimin e përlogaritur, përkatësisht nivelin e rrezikut të fondit të investimit, të përshkallëzuar sipas matricës së përcaktuar nga 1 deri në 7, duke theksuar treguesin në formatin e mëposhtëm:

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

rreziku më i ulët

rreziku më i lartë

Shoqëria duhet të japë:

- Sqarim për monedhën në të cilën produkti i sigurimit ofrohet, nëse kjo është e ndryshe nga leku dhe rreziqet që mund të ndodhin si rezultat i ndryshimeve të kursit të këmbimit.

- Një përshkrim të shkurtër të rrezikut të produktit të sigurimit dhe pritshmëritë për të ardhurat, duke theksuar se efekti i rrezikut tek produkti i sigurimit mund të jetë shumë më i lartë nëse nuk është ruajtur deri në maturim, përkatësisht deri në periudhën e rekomanduar për ruajtje, atje ku ekziston mundësia.
- Tregues për humbjen e mundshme, si dhe informacion se investimi mund të humbasë.
- Shoqëria duhet të paraqesë të dhëna për të ardhurat mesatare të fondit të investimit në përqindje me 4 shifra pas presjes dhjetore, në formatin si vijon:

Të ardhurat mesatare mujore <emërtimi i fondit të investimit >

	12 muajt e fundit	24 muajt e fundit	5 vitet e fundit
Të ardhurat mujore mesatare	%	%	%

IV. CILAT JANË PASOJAT NË RAST SE SHOQËRIA NUK MUND TË KRYEJË PAGESËN?

Në këtë pjesë të dokumentit, shoqëria duhet të informojë kontraktuesin/të siguruari, se ky i fundit mund të përballlet me humbje financiare për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve nga shoqëria e sigurimit ose shoqëria administruuese si pasojë e falimentit ose pa aftësisë paguese.

V. CILAT DHE SA JANË SHPENZIMET E LIDHURA ME PRODUKTIN?

- Shpenzimet periodike dhe të njëhershme

Në këtë seksion të dokumentit, shoqëria është e detyruar të pasqyrojë të gjitha shpenzimet që lidhen me produktin, duke dhënë të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me:

- Të gjitha shpenzimet e njëhershme, të tilla si shpenzimet hyrëse dhe dalëse, nëse ka;
- Të gjithë shpenzimet periodike dhe të vazhdueshme, të tilla si shpenzimet vjetore për transaksione me portofol dhe shpenzimet e tjera periodike dhe të vazhdueshme;
- Shpenzimet e paparashikueshme, siç janë kompensimet për sukses/performancë të shoqërisë;
- Informacion mbi primin e sigurimit duke specifikuar mundësinë e derdhjes si një pagesë të vetme, ose derdhjes me pagesa periodike me këste

- Ndarja e shpenzimeve

Shoqëria duhet të përshkruajë secilin prej shpenzimeve të ndarë në formë tabelore “Ndarja e shpenzimeve”, sipas zërave më sipër.

VI. OPSIONE PËR NDËRPRERJE TË PARAKOHSHME TË KONTRATËS DHE PASOJAT

Në këtë pjesë të dokumentit, shoqëria duhet që të japë:

1. Përshkrim të shkurtër të arsyeve për zgjedhjen e periudhës minimale ose periudhën e rekomanduar të kontratës së sigurimit.
2. Përshkrim të procedurës që do të ndiqet në rast të tërheqjes nga kontrata dhe rastet kur është e mundur tërheqja, duke përfshirë tregues të pasojave të ndërprerjes së kontratës në profilin e rreziqeve dhe në suksesin e produktit të sigurimit.
3. Informacion për penalitet të cilat mund të zbatohen për shkak të tërheqjes nga kontrata, përpara afatit të caktuar në kontratë, duke përfshirë informacionet për tarifa ose shpenzime të tjera, nëse zbatohen.

VII. INFORMACION PËR PARAQITJEN E ANKESAVE

Në këtë pjesë të dokumentit, shoqëria duhet që të sigurojë informacionet në vijim:

1. Hapat që duhen ndjekur për paraqitjen e ankesës për produktin e sigurimit, për shoqërinë ose për ndërmjetësin që këshillon ose shet produktin;
2. Link-un e faqes përkatëse të internetit për paraqitjen e ankesës;
3. Adresa/kodi i përditësuar postar dhe adresa elektronike në të cilën mund të paraqiten ankesat; dhe
4. Procedurën e paraqitjes së ankesave pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

VIII. INFORMACIONE TË TJERA TË RËNDËSISHME

Në këtë pjesë të dokumentit, shoqëria duhet të përmend të gjitha dokumentet me informacione plotësuese, si dhe njoftimin nëse këto dokumente janë të aksesueshme ose vihen në dispozicion të kontraktuesit/të sigurvearit me kërkesë të këtij të fundit.

Informacionet e përfshira në pjesën me titull “Informacione të tjera të rëndësishme” të dokumentit mund të jepen në formë të përmbledhur, duke përfshirë edhe link- un për faqen e internetit ku janë të aksesueshme detaje plotësuese.

Dokumenti me Informacionin kryesor duhet të përmbajë informacionin më të fundit.